



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 62, datë 17.03.2023

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, PALLATI NR. 120, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”; Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar; Raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. 2598/1 prot., datë 13.03.2023, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.120, Njësia Administrative nr.4, rruga “Aleksandër Goga”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Subjektet përfituese të pallatit nr. 120, në Njësinë Administrative nr.4, rruga “Aleksandër Goga” do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit të Zonës së Re për Zhvillim nr. 4, Njësia Administrative Durrës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 19.2.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, i ndryshuar.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 21.03.2023

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.120, RRUGA "ALEKSANDËR GOGA"

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
1	LULZIM DEDA	5	3+1
2	IBRAHIM BASHO, HAVA BASHO, ILIRJAN BASHO, KLESTA BASHO	7	3+1
3	KRISTINA BEJKO	3	2+1
4	ANTONIO GORGEJA, SHPRESA GORGEJA	3	2+1
5	DEMIR BARDHETI, FIDAJET BARDHETI	3	2+1
6	DERAND AHMETAJ, DONIKË AHMETAJ, HYSEN AHMETAJ	3	2+1
7	ALTIN JAUPAJ, ELSA JAUPAJ	3	2+1
8	ANDI QEVANI, ELIDONA QEVANI	3	2+1





BASHKIA DURRË
28/3/23 2702/4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 204/ prot.

Durrës, më 27.03.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.62 datë 17.03.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Nr 4, Rruga “Aleksandër Goga” Pallati Nr 120, i dëmtuar nga fatkeqësia e tërmetit të datës 26.11..2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

